

Krijo të ardhmen tënde!

Pejë, 17/08/2020

POLITIKA E CILËSISË DHE ARSIMIT

The CambridgeSchool Pejë SH.P.K., themeluar vite më parë dhe licencuar nga MASHT si institucion privat i arsimit para-universitar, është zhvilluar si një histori suksesi. Veprimtaria kryesore e Gjimnazit "Cambridge" është ofrimi i programeve mësimore, bazuar në metodat më të avancuara të edukimit. Praktikat ndërkombëtare përmes vizitave të ndryshme, pjesëmarrjes në iniciativa dhe implementimin e standardeve janë të gjitha vlerë e shtuar për plan-programin e shkollës tonë.

Të mësuarit në The CambridgeSchool Pejë SH.P.K., bazohet në interaktivitet, rritje të vetëbesimit tek nxënësit, zhvillim të mendimit kritik, përgjegjësinë sociale dhe ndaj komunitetit, pavarësinë dhe punën grupore. Ambienti i ngrohtë, i sigurtë, ndërtuar me pasion dhe mbushur me dashuri, krijon ndjenjën e një familje të madhe për të gjithë anëtarët e The CambridgeSchool Pejë SH.P.K. Risetë që ndikojnë drejtpërdrejtë në avancimin e mëtutjeshëm të cilësisë dhe arsimit janë synim i ndjekjes dhe përmbushjes.

Nëpërmjet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë, sipas standardit ISO 9001:2015 dhe standardit për arsim ISO 21001:2018 do të arrijmë përmbushjen e kërkesave të nxënësve, prindërve ose kujdestarëve, shërbimeve, pronarëve, punonjësve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Për të arritur qëllimin tonë, të gjitha palët e angazhuara, duke filluar nga menaxhmenti deri tek të gjithë punonjësit e **The CambridgeSchool Pejë SH.P.K.**, janë të obliguar që të:

- i. Përmbushin kërkesat, nevojat dhe pritshmërinë e nxënësve dhe prindërve ose kujdestarëve;
- ii. Veprojnë sipas përgjegjësisë të ndara dhe procedurave të përcaktuara;
- iii. Përmbushin në vazhdimësi kërkesat që dalin nga institucionet përkatëse që lidhen dhe afektojnë punën e The CambridgeSchool Pejë SH.P.K.;
- iv. Punojnë në vazhdimësi për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve punuese dhe aftësive të personelit;
- v. Veprojnë në mënyrë preventive me qëllim të evitimit të jokonformiteteve;
- vi. Angazhimi për përmirësimin të vazhdueshëm të efektivitetit të sistemit të menaxhimit;
- vii. Zgjerimi i gamës së produkteve/shërbimeve,
- viii. Përdorimi i teknologjive të reja;
- ix. Përmirësimi i infrastrukturës;
- x. Zvogëlimi i kostos së produkteve;
- xi. Njohin, zbatojnë dhe rishikojnë politikën e menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë.

Obligimet e vendosura mund të arrihen vetëm me dije, profesionalizëm, përkushtim dhe motivim të punëtorëve tanë, ngritjen e aftësive të tyre, përcjelljen e zhvillimit teknologjik dhe kërkesave të tregut.

Drejtori:

Prof. Jakup Beqaj



+383 44 138 336
+383 49 554 500



info@gjimnazicambridge.com
www.gjimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitroviça
pn. 30 000 Pejë